



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:007402

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05515743

CAP.nr.1827/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, e përbërë nga gjykatësi individual Dr.sc. Rafet Haxhaj, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit SH.A. "M..." me seli në Mitrovicë, kundër debitorit A. O Komuna e Vushtrrisë, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga debitori, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri CPP.nr.155/2022 të datës 29.09.2023, me datë 27.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa e debitorit A. O, Komuna e Vushtrrisë, si e pa bazuar, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri CPP.nr.155/2022 i datës 29.09.2023, VËRTETOHET.

Arsyetim

Me aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, refuzohet i pabazuar prapësimi i debitorit A. O, i ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit të përmbartuesit privat A. M në Vushtrri, P.nr.1450/22 të datës 03.11.2022.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur debitori për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit të ndryshohet aktvendimi i atakuar me të cilën do të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit.

Gjykata e Apelit e Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se kreditori "M..." ka parashtruar propozim për Lejimin e Përmbarimit, kundër debitorit A. O, për pagesën e borxhit në emër të ujit të harxhuar në shumën 247.12€.

Përmbaruesi Privat A. M, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të ekstraktit nga librat afariste, lidhur me borxhin në shumën prej 247.12 €, të krijuar për shkak të mos pagesës së furnizimit me ujë.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit në afat ligjor debitori ka paraqitur prapësim përmes të cilit ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarues duke theksuar se borxhi është i parashkruar konform nenit 360 të LMD-së.

Kreditori në afatin ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim dhe e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit si të pabazuar, dhe ka kërkuar që të refuzohet prapësimi i debitorit. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar me ankesë.

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e miraton në tërësi edhe gjyqtari i vetëm i Gjykatës së Apelit, për arsye se, vendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës dhe se e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të drejtë, për të cilat çështje, gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjyqtari individual gjen se propozimi për përmbarim është parashtruar më datën 02.11.2022, për periudhën kohore 31.01.2021 deri 31.08.2022, ndërsa lartësia e borxhit të kërkuar është 247.12€. Gjyqtari i vetëm e miraton vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë se, në rastin konkret borxhi i kërkuar nga kreditori për periudhën 31.01.2021 deri me 31.08.2022 në shumën 247.12€, është i bazuar dhe se nuk është parashkruar, kjo bazuar në nenin 360.1 të LMD-së i cili përcakton se: "Kërkesat të cilat parashkruhen pas një viti: kërkesat për furnizimin me energji elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake". Lidhur me provat shkresore të cilat debitori i ka bashkangjitur ankesës, gjyqtari vetëm i Gjykatës së Apelit gjen se, në nenin 180.1 të LPK-së është përcaktuar se: *"Në ankesë nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të propozohen prova të reja, përveç se kur ankuesi jep prova*

se pa fajin e vet nuk ka mundur t'i paraqesë, përkatësisht t'i propozojë gjer në përfundimin e shqyrtimit kryesor në gjykatën e shkallës së parë”.

Për arsyet e theksuara si më lartë, gjyqtari i vetëm i Gjykatës së Apelit, ka vendosur që pretendimet ankimore të kreditorit dhe të debitorit të refuzohen në tërësi si të pa bazuara dhe që aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjykatësit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjykatësi individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 par.1 pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 3.2 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E AELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.1827/2023, me datë 27.03.2024.

GJYKATËSI,
Dr.sc. Rafet Haxhaj